

AIŞHE ALIÇKAJ
MIRËMËNGJES, SHPIRTI PËRGJIGJET
POEZI

BOTIMET TOENA

AISHE ALIÇKAJ

MIRËMËNGJES, SHPIRTI PËRGJIGJET

poezi

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor letrar: Shuaip Duka

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817839

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

MIRËMËNGJES, SHPIRTI PËRGJIGJET

Syrin kur hap xhevahir,

Një flad dashje më thotë: Mirëmëngjes,
Dhe pse, ndoshta, akoma nuk është gdhirë,
Si puhiza e majit më përkëdhel.

Mirëmëngjes, shpirti përgjigjet
Dhe zërin nuk e ngre dot,
Se dhe tjetri përbri përpëlitet,
Dikush dhe atij, mirëmëngjes, i thotë.

Se shpirtin e madh, perandori,
Logjika kurrë s'mundi ta thotë,
Ndaj dhe heq e vuan i gjori,
Të drejtën s'e gjeti dot.

UNË TË RRYTA SI DIELLI

Unë të rryta si dielli, të stolisa plot hijeshi,
Si diellin e majit, që me melodinë e rrezeve flet.

Fëmija im, drita e syve të mi,
Si lulëkuqja e brishtë në agimet plot me vesë,
Si ngjyra e saj mëndafsh, puhiza që këndon për
dashuri.

Fëmija im, agimi im purpuruar,
Zemrën tënde e mbusha me lule plot freski.

Fëmija im, ti je buzëqeshja e zemrës sime,
Shkruar mbi buzët e mia dritëruar,
Mjegullën e zezë, kur të afrohej,
Ta largova si me magji.
Se jeta çdo ditë përflaket,
Me ironinë e fatit të pabesuar,
Si një i trazuar det,

Duam apo nuk duam, derën do t'ia hapim fletë më fletë.
E ashtu, të luftosh me fatin,
Të kacafytësh, për vdekje a jetë.

Unë të rrita kënaqësisht të lumtur,
Dimrin nuk e lashë të afrohej, të përkëdheli pranvera.
Që derën kur ta hapësh, të derdhen lulëshqerra.

SI TA FSHEH KËTË DASHURI

Ta fsheh dua këtë dashuri, jam përvëlur,
Më zien ky shpirti, më digjet flakë për ty,
Ku ta fsheh i dashur, jemi të martuar,
Se bota e ftohtë ka nga katër sy.

Të lutem fshihe brenda në zemër,
E shpirti pa faj, të heqë e të vuajë,
Kësaj i thonë dashuri pa emër,
Të dënuar jemi për t'u përvëlur.

Mallkuar qofshin ato paragrafë e kode,
Që na kryqëzojnë si Krishtin në kryq,
Dua t'ia nxjerr të katër sytë kësaj bote,
Zemrës së dashuruar, mos t'i bëjnë më gjyq.

Se brenda meje vërtet shpirti heq e vuan,
Nuk ka rëndësi që s'i gjej dot emër,
Le ta quajnë të tjerët si të duan,
Unë thjesht do të them: Të dua zemër.

ANTINJERI

Nga ç'planet ke zbritur ti o antinjeri,
O qenie pa zemër, o antizot,
Në cilin rreth të ferrit je ulur e rri,
Të kërkoj sozinë, e s'ta gjej dot.

Ti që në orgazëm kalon, kur këput një jetë,
Në pellgje gjaku zhgërryesh vesh më vesh,
I baltosur nga balta, i mbuluar nga retë
Me krijesa të pafajshme tallesh e qesh.

E neveris racën tënde, e përçmoj o kukuth,
E urrej si njeri, si grua, si nënë,
Mallkimi si rrufe të ndjektë udhë më udhë,
Mos pafte soji yt as diell, as hënë.

VESA E PURPURT

Moj vesë e purpurt,
O ylber i majit,
Ç'më lëmon mbi gushë
E ma shuan zjarrin.

Zjarrin seç ma shuan
Mbi muskujt djalosharë,
Moj vesë e bekuar
Më bëre derman.

O ylli me bisht,
Mbi gjoksin tim tretesh,
Moj lulja e brishtë
Veç aromë mbetesh.

Si lumi rrëshqet
Në venat e mia,
Më pushton të tërën
S'më duhet liria.

DO TË DOJA

Do të doja, qoftë dhe një herë,
Që malli përvëlur të bënte një vizitë,
Dhe t'i këndoja në zjarre përvëlím si atëherë,
Kur loti i dashurisë na ndriste sytë.

Të të gjej dua, o më i shtrenjti peshqesh,
Sikur vetëm një ditë të më lumturoje,
Të flas, të qesh me ty ashtu çakërrqejf,
Të puthemi pa teklif, plagët t'm'i shëroje.

Ëndërroj për ty, të lozim dua,
Në kopshtin si dikur, mbushur luleshqerra,
Nën hijen e mollës apo nën një ftua,
Dhe buzët e thata të na njomë pranvera.

Të flas me ty, të bëj bur-bur,
Të qesh, të këndoje nën dritën e hënës,
Dhe ashtu të përqaftuar si dikur,
T'i bëja bisht shikimit të nënës.

Ndoshta një çast shfaqesh pa pritur
Dhe me dyshim troket te dera,
Edhe në krahët e vdekjes të jem,
Me zë të mekur do të them: - Erdhi pranvera.

Dhe ashtu nga varri si e dalë,
Zvarrë-zvarrë do të ec drejt teje,
Do të puth me buzën e tharë,
Do të përgjërohem të vish pas meje.

KUJTIMET MBETEN

Kujtimet mbeten në këtë jetë
Një dhimbje a dashuri,
Jeta është e bukur dhe pa të madhen kuletë,
Lum kush e shijon çdo moment,
Dhe kur dielli ndrin dhe kur ka stuhi.

PËR ATA SY MALLI MË TRETË

Syri yt, syri jeshil
Porsi livadhi në pyll,
Larg nga unë, s'po duroj dot,
Kurbeti më mbërthen fort.

Për ata sy malli më treti,
Mall i hidhur, mall kurbeti,
Lart në qiell vizatuar,
Oh, ç'jam djegur përvëlur.

O shokë më dogji malli
Për dy sytë nga vatani,
Drita e tyre shndrin dhe hije,
Oqean kënaqësie.

Dua sytë e bukur,
Dua t'i kem pranë,
Të më mjekojnë dertet,
Të më shërojnë xhanë.

DHIMBJA

Kurrë nuk e mblodha dhimbjen
Nëpër ferra e shpërndava.
Dhe të plekset, të përdridhet
Nëpër driza, gjemba, t'i zhduket fara.

Jeta është gjyq pa mbarim,
Dhe pa dhimbjen s'ecim dot,
Nuk lind dielli në agim
Pa dhimbje, lodhje e lot.

Sa për dashurinë e virgjër,
Dhe kur vjen sa një pikë shi,
Unë e mbledh, me të ngre digën,
Liqeni mbushet aty.

E pastaj do t'i hap portat,
Të bjerë mbi makineri,
Në dritë le të mbytet bota
Nga e shtrenjta dashuri.

TË LUTEM BIJË, HAJDE MË MBA

S'dua ta besoj, kur më flisnin
Sytë e tu të përlotur baba,
Më duket dhe tani, i largët, i huaj, ai shikim,
Ajo fjalë e trishtë, mbi buzët e tua përvëlim,
Të lutem bijë, hajde më mba!

Ti ishe për mua një dragua,
Një oqean i agimeve të arta që dua,
Ndaj s'doja ta besoja lutjen e zbehur,
Bashkë me heshtjen e venitur,
Kur në ata sy butësisht, e paqshëm u shkrua.

Sa i afërt më duket dhe sot ai shikim,
Ajo dhimbje, brenda syve të tu përvëlim,
Belbëzimi në buzën tënde të tharë
Dhe ai ball diell, në brazda i ndarë.

Asnjëherë nuk do ta besoj baba,
Lutjen e tulatur në sytë e tu pa shkëlqim,
Të lutem bijë, hajde më mba,
Dhe perden e zezë që mbuloi një agim.

NGJALË E KARAVASTASË

Moj ngjalë e Karavastasë
Mes holla trupi selvi,
I ziu ç't'i bëj sevdasë,
Do mbytem aty me ty.

Kur më shkon si lule mali,
Dhe gurët i xhelozon,
Gjoksin ta shtrëngon fustani
U çlodhsha në atë ballkon.

Qafëgjata si sorkadhe,
Syrin kur ma rrotullon,
Tunden pllakat, hapen varret,
Lum ai që të shijon.

Moj lulja mbi belvedere,
Flokëdredhura ujëvarë,
Lule molle, erë pranvere,
Vdeksha në s't'u qasa pranë.

Aman moj jepi karar,
Mbytëm në atë kaltërsi,
Këpute kopsën e parë
Të futem aty të rri.

NË VATHIN TIM NUK BIEN PRETË (BISHAT)

Dhe në dritën e çirakut
Të pishës e të biçakut
Dhe kur drita m'u ndërrua
Me elektrik e pirua,
Kurrë nuk u lodha shumë
Të shkoj paratë në shtrungë.
E bëj lehtë këtë punë;
Ato s'më duan shumë,
Janë në mëri me mua
Si ato dhitë xanxare,
Të zotin s'e duan fare,
Më largohen porsi era
Nëpër ca vathe të tjera.
Kështu natën jam i qetë,
Më zë gjumi si sheleg,
Në vath tim nuk bien pretë.